



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-7837/21
Kaçanik, 18.03.2021

Në bazë të nenit 5 (d) dhe (e) lidhur me nenin 12.2 (d) dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 78, 79.3 e lidhur me neni 6.2 të Statutit të Komunës 01Nr. 60/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 63 të Rregullores Nr. 104/01-1991/21- për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale të datës 29.01.2021, të Propozim Organogramit të Ekzekutivit të Komunës 02 Nr. 104/02-7837/21 prej datës 12.03.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 18 Mars 2021, mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E ORGANOGRAMIT TË KOMUNËS KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Struktura Organizative e Organeve të Komunës Kaçanik: Organit Legjislativ- Kuvendit të Komunës; Organit Ekzekutiv- Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale, me tekstin e mëtutjeshëm, “Organogrami i Komunës së Kaçanikut” 01Nr. 02-104/02-7837/21, i hartuar nga Ekzekutivi i Komunës.
2. Në Organogramin e Komunës së përcaktuar si në pikën 1. të këtij vendimi, është bërë struktura organizative, raportuese, ndarja e përgjegjësisë në formë hierarkie, duke filluar nga Kuvendi i Komunës- organit më i lartë Legjislativ, Kryetarit të Komunës- organit më lartë Ekzekutiv- dhe të Organeve të Administratës- Drejtorive Komunale.
3. Në strukturën organizative është caktuar edhe nomenklatura e akteve të; Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë Komunale, si vijon:
 - 3.1 Me **01** – Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të Kuvendit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Komitetet dhe Komisioneve të cilat i formon KK si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen.
 - 3.2 Me **01** - Shënohen Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Zyrave të Kryetarit të Komunës, si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen.
 - 3.3 Me **02** - Shënohen Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Sektorëve të saj, si dhe të gjitha parashtresat që i adresohen kësaj drejtorie.
 - 3.4 Me **03** - Shënohen Aktet dhe dokumente tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.5 Me **O4** –Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit dhe sektorëve të saj, si dhe të gjitha parashtresat që i adresohen kësaj drejtorie.

3.6 Me **O5** – Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Buxhet dhe Financa dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.7 Me **O6** - Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.8 Me **O7** - Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës si dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.9 Me **O8** - Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë si dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.10 Me **O9** - Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe sektorëve të saj, si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

3.11 Me **10** - Shënohen të gjitha Aktet dhe dokumentet tjera zyrtare të cilat bien në kompetencë të drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe sektorëve të saj si dhe të gjitha parashtresat të cilat i adresohen kësaj drejtorie.

4. Në nenin 62 të Rregullores Nr.104/01-1991/21- Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale të datës 29.01.2021 është e përcaktuar së drejtoritë listuar në nenin 6.1, listuar si në këtë vendim, do të funksionojnë si “Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport” dhe “Drejtoria e Buxhetit, Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit” deri më 1 janar 2022.

5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Organogrami i Përgjithshëm i Komunës, Organogrami i Kryetarit të Komunës dhe Organogrami i 09 Drejtorive Komunale.

6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryesuesi i KK dhe organet tjera të KK, Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit dhe organet tjera të KK;
1. Kryetari i Komunës;
2. Të gjitha Drejtoritë Komunale; dhe
3. Arkivi.





REPUBLIKAT E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



ORGANOGRAMI I KOMUNËS SË KAÇANIKUT
(Struktura administrative e Komunës së Kaçanikut sipas Statutit)


1	Data	18.03/21	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	01M7.02	-104/02	-7837/21	

**01.LEGISLATIVI-
KUVENDI I KOMUNËS**

- KOMITETI PËR POLITIKË
DHE FINANCA
- KOMITETI PËR
KOMUNITETE
- KOMITETET
KONSULTATIVE
- KOMITETET TJERA
- KOMISIONET

**01.KRYESUESI I
KUVENDIT**

ASISTENT I KRYESUESIT



**QYTETARËT-ZGJEDHËSIT-
ELEKTORATI**

**01.EKZEKUTIVI-
KRYETARI I KOMUNËS**

01.NËNKRYETARI

- 02. DREKTORIA E ADMINISTRATËS SË
PËRGJITHSHME
- 03. DREKTORIA E SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
- 04. DREKTORIA E ARSIMIT
- 05. DREKTORIA E BUXHETIT DHE FINANAVE
- 06. DREKTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE
MBROTJES SË MJEDISIT
- 07. DREKTORIA E SHËRBRIMEVE PUBLIKE DHE
EMERGENCËS
- 08. DREKTORIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE PYLTARISË
- 09. DREKTORIA E KULTURËS, RINISË DHE
SPORTIT
- 10. DREKTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE
TURIZMIT

01.ZYRA E PERSONELIT

01.ZYRA E PROKURIMIT

**01.ZYRA PER
KOMUNITETE DHE KTHIM**

**01.ZYRA/NUESIA PËR AUDITIM
TE BRENDSHEM**

01.ZYRA LIGJORE

**01.ZYRA E
INSPEKTORATIT**

**01.ZYRA PËR BARAZI
GJINORE DHE D.NJ**


**01.ZYRA PËR INTEGRIME
EVROPIANE**

**01.ZYRA E TEKNOLOGJISE
INFORMATIVE**


01.ZYRA E INFORMIMIT

01.ZYRA E KUVENDIT


ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË ARSIMIT



ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË BUXHETIT DHE FINANCAVE




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS


DREJTORI




ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE PYLLTARISË



ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



ORGANOGRAMI I DREJTORISË TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Direkcija za Opštu Upravu/Department of General Administration



LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	02.NR.104/02-7837/21		
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit - Kemal Murseli Sekretarinë e Kuvendit		
KOPJE:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:	//		
NGA/OD/FROM:	Festim Neziraj - Drejtori i DAP		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Sqarim		
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Data:	16.03.2021
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:	
Room No.:	Extension:	Date:	
PËR AKTIVITET			☒
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE			0

I nderuar,

Më lejoni që nëpërmjet kësaj shkrese t'iu sqaroj se për pikën e rendit të ditës "Organogrami i Komunës" është bërë lëshim procedural dhe pika e lartshënuar ka ardhur pa shkrese përcjellëse për shkak të disa mosfunksionimeve teknike.

Gjithashtu ju sqaroj se:

1. Kjo pikë ka ardhur në Kuvend me prioritet dhe urgjencë si shkak i nenit 63 i Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, ku shprehimisht thuhet "Në afatin prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, Kryetari i Komunës nxjerr organogramin e përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut dhe organogramet për çdo drejtori, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje".
2. Sipas Statutit të Komunës, drejtoria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit si dhe drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, do të funksionojnë në kuadër të drejtorive aktuale, mirëpo në organogramin e paraqitur duhet të jenë të ndara sepse funksionimi i tyre me drejtore organizohet nga data 1 janar 2022.
3. Organogrami paraqet strukturën organizative, raportuese dhe ndarjen e përgjegjësi në formë hierarkike dhe si i tillë, nuk shton numrin e zyrtarëve publik dhe as gradime të panevojshme. Këto aspekte janë të sqaruara në nenin 3, paragrafi 5 dhe 6 i Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale.

Në fund, duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, shprehim keqardhje për këtë lëshim me shpresën që mos të ndodhë asnjëherë në të ardhmen.

Me respekt!